# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 08.01.2025 | Kërkesë për t'u pajisur me informacion për:<br><br>1. Sa është numri total i bizneseve të regjistruara në Bashkinë Korçë?<br><br>2. Sa është numri i bizneseve të reja, të regjistruara përgjatë vitit 2024?<br><br>3. Sa është numri i bizneseve të cila janë ç'regjistruar "mbyllur" përgjatë vitit 2024? | 10.01.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 08.01.2025, po ju vendosim në dispozicion informacionin nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Korçë.<br>**1. Sa është numri total i bizneseve të regjistruara në Bashkinë Korçë?**<br>Numri total i bizneseve të regjistruara në Bashkinë Korçë është 3450 subjekte,ojf dhe institucione.<br>**2.Sa është numri i bizneseve të reja, të regjistruara përgjatë vitit 2024?**<br>Numri i bizneseve të reja, të regjistruara përgjatë vitit 2024 është 345.<br>**3. Sa është numri i bizneseve të cila janë ç'regjistruar "mbyllur" përgjatë vitit 2024?**<br>Numri i bizneseve të cilat janë ç'regjistruar "mbyllur" përgjatë vitit 2024 është 207. | E plotë | S'ka tarifë |
| 2. | 28.02.2025 | Kërkesë për t'u pajisur me informacion për:<br><br>- Sa raste të dhunës në familje ka trajtuar në pesë vitetet e fundit, specifikoni sipas viteve.<br>-Sa prej këtyre rasteve të | 04.03.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 28.02.2025, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se:<br><br>1. Bashkia Korçë gjatë pesë viteve të fundit ka trajtuar rastet e dhunës në familje si më poshtë: | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | verifikuara kanë qënë dhunë me bazë gjinore? -A ka bashkia qendër për strehimin e personave denoncues të dhunës në familje? Nëse po specifikoni rreth saj: sa punonjës shërbejnë, çfarë ofron qendra, ku ndodhet ajo? - Sa ka qënë fondi i vënë në dispozicion për këtë qendër për pesë vitet e fundit, specifikoni sipas viteve. - Nëse Bashkia nuk ka një qendër të tillë a ka pasur projekte për hapje të saj, nëse po përse nuk është realizuar dhe kur do të realizohet? | | 2020-119 raste<br><br>2021-99 raste<br><br>2022-78 raste<br><br>2023-93 raste<br><br>2024-122 raste<br><br>2. Rreth 20 % të rasteve të denoncuara kanë qenë dhunë me bazë gjinore.<br><br>3. Bashkia Korcë ka një strehëz emergjente për viktimat e dhunës në familje e cila në momentin që ka një rast dhune në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me një OJF, dedikon një punonjës për sa kohë viktima e dhunës në familje qëndron në strehëz.<br><br>Vendi i strehëzës ndodhet në periferi të qytetit, lagjja nr 15.<br><br>4. Fondi i vënë në dispozicion për strehëzën emergjente për pagesën ujë, qera, drita në 5 vitet e fundit është si më poshtë:<br><br>2020-288,000 lekë<br><br>2021-288,000 lekë<br><br>2022-252,000 lekë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2023-252,000 lekë<br><br>2024-252,000 lekë<br><br>Pjesa tjetër e financimit për plotësimin e nevojave të viktimës së dhunës në familje sigurohet nëpërmjet marrëveshjes së bashkupiminit me OJF. | | |
| 3. | 06.03.2025 | Kërkesë pë t’u pajisur me informacion: 1. Sa shtëpi mbështetëse ndodhen në Korçë?<br><br>2. Sa është kapaciteti i tyre?<br><br>3. Sa persona trajtohen aktualisht aty?<br><br>4. Cilat kategori trajtojnë ato dhe cilat janë trajtimet që ofrohen?<br><br>5. Cili është protokolli referimeve dhe i trajtimeve që ofrohen aty?<br><br>6. Cili është buxheti i parashikuar për to?<br><br>7. Ju lutem të na mundësoni (nëse ka) një pasqyrë të | 10.03.2025 | Kërkesën tuaj për informacion duhet t'ja drejtoni Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, jo Bashkisë Korçë. | E delegu ar | S’ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | investimeve vendore ose ndërkombëtare në<br><br>8. 5 vitet e fundit.<br><br>9. A ka një databazë qendrore dhe a keni akses? Nëse po, si është procedura e përditësimit, mirëmbajtjes<br><br>së regjistrave online ose fizik?<br><br>10. Cilat janë problemet apo mangësitë kryesore që kërkojnë një vëmendje të menjëhershme në këto<br><br>shërbime?<br><br>11. Sa staf ka këto shteëpi dhe cilat janë pozicionet e tyre?<br><br>12. A i nënshtrohen ata trajnimeve të vazhdueshme?<br><br>13. Cili është protokolli i trajtimit të të miturve me çrregullime të shëndetit mendor?<br><br>14. Si ndiqen personat pas daljes nga institucioni, në rastet | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kur ata kanë qenë të shtruar për një kohë të<br><br>caktuar? | | | | |
| 4. | 11.03.2025 | Kërkesë për t'u pajsiur me informacion mbi Strukturen e Diasporës dhe Migracionit. | 25.03.2025 | Kërkuesit ju vendosën në dispozicion të gjitha të dhënat e detajuara mbi Strukturën e Diasporës dhe Migracionit.(në formë pyetësori) | E plotë | S'ka tarifë |
| 5. | 19.03.2025 | 1.A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar -dhjetor 2024? Nëse po, sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a<br><br>mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë?<br><br>2.Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2024)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? | 02.04.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 19.03.2025, sipas të dhënave të marra nga drejtoritë përkatëse ju bëjmë me dije si më poshtë:<br><br>**1.** Buxheti për rininë nuk buxhetohet më vete, por vlera e buxhetit përcaktohet në bazë të programeve buxhetore për çdo njesi shpenzuese të specifikuara nga Bashkia Korçë për projektet që zbatohen, konkretisht: Programi i arsimit bazë; programi i arsimit te mesëm të përgjithshëm; programi i arsimit profesional; programi sport dhe argëtim ku përfshihen të rinjtë.<br>**2.** Numri total i punonjësve në Bashkinë Korçë për vitin 2024 është 278, nga të cilët 125 femra dhe 153 meshkuj. Asnjë prej tyre nuk i përket PAK.<br>**3.** Për vitin 2024, numri i të rinjve të punësuar pranë Bashkisë Korçë (18-29 vjeç) është 54. Të ndarë sipas gjinisë 33 prej tyre janë femra dhe 21 janë meshkuj.<br>**4**.Të rinjtë e punësuar pranë Bashkisë Korçë nuk mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse. | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3.Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa janëmeshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?<br><br>4.Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?<br><br>5.A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvillura specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?<br><br>6. A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh janë funksionale?<br><br>7. A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj | | **5.** Bashkia Korçë e ka konsideruar rininë si një nga prioritetet kryesore, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo-fitimprurëse. Bashkëpunimi me këto organizata ka bërë të mundur hartimin dhe implementimin e projekteve për t'ju dhënë zgjidhje problematikave lokale rinore. Mbështetja e të rinjve nga Bashkia përfshin: nxitjen për punësim, edukimin, sportin, kulturën, vullnetarizmin etj. Qendra Sportive Korçë është një tjetër hapësirë multifunksionale, ku të rinjtë e grupmoshave të ndryshme zhvillojnë talentet e tyre në disiplina të ndryshme sportive. Vlen të përmendet Korça Innovation Technology Hub, ku zhvillohen kurse, trajnime në fushën e programimit, teknologjisë dhe menaxhimit të rrjeteve sociale. Ky hub ju ofron mundësi te rinjve për t'u kualifikuar dhe më pas të punësohen në këtë treg, në botën digjitale. Aktualisht ka përfunduar rikonstruksioni i Qendrës Rinore dhe shumë shpejt do të fillojë të funksionojë. Kjo qendër do të jetë shtesë për paketën rinore që ofron Bashkia Korçë për të rinjtë, një hapësirë për të rinjtë, ku do të ofrohen më shumë mundësi për edukimin joformal, aktivitete kulturore dhe artistike, shërbime në funksion të këshillimit të karrierës, mundësi për projekte sociale dhe vullnetarizëm, teknologji e shumë të tjera. Një tjetër fokus i rëndësishëm i Qendrës Rinore do të jetë edhe përfshirja dhe mbështetja e grupeve të margjinalizuara si dhe parandalimi i problemeve të rinisë me anë të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar - dhjetor 2024.<br><br>Nëse po, cilat janë ato?<br><br>8. Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh, individë, etj)<br><br>9.A keni një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivitete janë organizuar nga KVR përgjatë 2024?<br><br>10.Për çfarë lloj mbështetje / iniciativa/ bashkëpunime keni nevojë për të përmirësuar funksionet e KVR në qytetin tuaj?<br><br>11.Sa të rinj janë të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? | | ofrimit të shërbimeve mbështetëse të këshillimit dhe ndërgjegjësimit.<br>**6-7.** Në Janar 2021, pranë Bashkisë Korçë është krijuar një vend i dedikuar për rininë brenda Kabinetit të kryetarit të bashkisë. Me vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr.1299, datë 16.12.2025 është ringritur Këshilli i Ri Vendor Rinor.<br>**8.** Për të gjitha aktivitetet rinore, proceset konsultative, projektet me në fokus rininë Bashkia Korçë bashkëpunon me institucione/organizata në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.<br>**9.** Aktualisht jemi duke përfunduar draftin për Planin Vendor Rinor 2025-2028.<br>**10.** Me qëllim përmirësimin e funksionit të KVR lind nevoja për fuqizim të Këshillit Vendor Rinor, binjakëzime me Këshille Vendore Rinore të tjera brenda dhe jashtë vendit, alokim fondi të posaçëm për aktivitete të ndryshme që mund të dalin gjatë vitit.<br>**11**. Në Këshillin Vendor Rinor janë 7 femra dhe 3 meshkuj. Asnjë prej tyre nuk i përket PAK.<br>**13-14** Përqindja e të rinjve në konsultimet publike është afërsisht 30%. Njoftimi i të rinjve bëhet nëpërmjet rrjeteve tona sociale si edhe faqes zyrtare të web-it.<br>**15.** Numri total i përfituesve të ndihmës ekonomike për vitin 2024 ka qenë mesatarisht 750 familje për çdo muaj, 180 janë kryefamiljare femra dhe 570 përfitues meshkuj.<br>**16.** Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të ndihmës ekonomike është 463, nga të cilët 256 femra dhe 207 meshkuj. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 12.A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimit (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj) për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konsistuar ato?<br><br>13.Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese?<br><br>14. Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së webit të bashkisë<br><br>(website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram.<br><br>15. Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?<br><br>16. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike | | **17**. Numri total i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2024 është mesatarisht 1920 përfitues, nga të cilët 620 femra dhe 1300 meshkuj.<br>**18.** Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të pagesës të aftësisë së kufizuar për vitin 2024 është mesatarisht 450 përfitues, prej të cilave 230 femra dhe 220 meshkuj.<br>**19.** Numri total i personave që kanë qenë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024 është mesatarisht 800 persona, prej të cilëve 340 femra dhe 46 meshkuj.<br>**20.** Numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilët kanë qenë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024 është rreth 40 përfitues, nga të cilët 28 femra dhe 12 meshkuj. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për vitin 2024? prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?<br><br>17. Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?<br><br>18. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?<br><br>19. Sa është numri total i personave të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024?<br><br>Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?<br><br>20. Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | 24.03.2025 | Kërkesë për t'u pajisur me informacion:<br><br>1. A përfunduar procesi i regjistrimit të të gjitha pronave të bashkisë<br><br>në varësinë dhe menaxhimin e bashkisë tuaj?<br><br>2. Nëse jo, në cilën fazë është? Çfarë e ka penguar përfundimin e<br><br>këtij procesi?<br><br>3. Nëse po, si e keni menaxhuar ju atë? Sa janë të ardhurat e shtuara<br><br>në buxhetin e bashkisë tuaj nga ky zë? Kryesisht si i keni përdorur?<br><br>4. Sa ambiente me qira keni marrë ju për istitucionet vartëse? Sa<br><br>është hapsira dhe sa është vlera që ju paguani për secilin rast? A | 26.03.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 24.03.2025, ju bëjmë me dije si më poshtë:<br>1. A është përfundura procesi i regjistrimit të të gjitha pronave të Bashkisë në varësi dhe menaxhimin e bashkisë tuaj?<br>· Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1532 datë 19.11.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës" e ndryshuar, Bashkisë Korçë i është transferuar lista përfundimtare e pronave të paluajshme publike, shtetërore, në pronësi ose në përdorim ,të cilat ndodhen brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të saj.<br><br>Lista fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 965.<br><br>Nga këto transferuar në pronësi 739 numra rendorë dhe 3 në përdorim, 223 numra rendorë pjesë e listës nuk i janë transferuar në pronësi apo në përdorim Bashkisë Korçë.<br><br>Jemi pajisur më çertifikatë pronësie për 222 prona.<br><br>Si pasojë e reformës territoriale me vendimin nr.510 datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit,aktivëve të trupëzuara dhe të patrupëzuara,të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e Qeverisjes Vendore,të prekura nga riorganizimi | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mund të na vini në dispozicion kontrat konkrete për secilin rast?<br><br>5. A e keni aplikuar taksën 3% për ndërtimet e reja? Si është vjelë kjo<br><br>taksë, në vlerë monetare apo ambiente? Sa janë përfituar<br><br>konkretisht para dhe sa sipërfaqe ndërtimi?<br><br>6. Këto të ardhura për çfarë janë përdorur? | | Administrativo-Territorial" Bashkia Korçë trashëgoi të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme, të ish Komunave, duke ushtruar të drejtën e pronësisë, si dhe të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.<br><br>· Ish Komunës Lekas sot Njësia Administrative Lekas e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 699, datë 21.05.2008 "Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Lekas , të Qarkut Korçë"e ndryshuar.<br><br>· Ish Komunës Mollaj sot Njësia Administrative Mollaj e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 1057, datë 16.07.2008 "Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Lek, të Qarkut Korçë"e ndryshuar.<br><br>· Ish Komunës Voskopojë sot Njësia Administrative Voskopojë e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 1155, datë 13.08.2008 "Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Voskopjë, të Qarkut Korçë",e ndryshuar.<br><br>· Ish Komunës Voskop sot Njësia Administrative Voskop e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 1641 datë 17.12.2008 "Për miratimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në  përdorim  të Komunës Voskop, të Qarkut Korçë”, e ndryshuar.<br><br>·        Ish Komunës Bulgarec sot Njësia Administrative Bulgarec e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 276 datë 18.03.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në  përdorim  të Komunës Voskop, të Qarkut Korçë”, e ndryshuar.<br><br>·        Ish Komunës Drenovë sot Njësia Administrative Drenovë e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 742 datë 08.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në  përdorim  të Komunës Voskop, të Qarkut Korçë” e ndryshuar.<br><br>·        Ish Komunës Vithkuq sot Njësia Administrative Vithkuq e Bashkisë Korçë, me VKM nr. 455 datë 06.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në  përdorim  të Komunës Voskop, të Qarkut Korçë”, e ndryshuar.<br><br>2. Nëse jo ,në cilën fazë është?Cfarë e ka penguar përfundimin e këtij proçesi? | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Pavarësisht aplikimeve për regjistrimin e pronave, kemi hasur vështirësi në pajisjen me çertifikata pronësie pasi rezulton se listat e inventarit kanë gabime, të cilat konsistojnë në:<br><br>- Gabim në numrin e pasurive (mospërputhje e numrit të pasurisë në listën e inventarit me atë në hartën kadastrale);<br><br>- Prona pa numër pasurie;<br><br>- Vendndodhje e gabuar (ndryshon pozicioni gjeografik);<br><br>- Disa prona e kanë sipërfaqen në total, pa e specifikuar sipërfaqen e tyre veçmas.<br><br>Në maj të vitit 2021 hyri në fuqi ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” i cili midis të tjerash ka për qëllim:<br><br>d) përfundimin e procesit të inventarizimit të pronave të paluajtshme të shtetit, përditësimin e inventarëve të pronave të paluajtshme të pushtetit qendror dhe atyre të transferuara njësive të vetëqeverisjes vendore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe të regjistrimit në regjistrin publik;<br><br>Për sa më lart, Bashkia Korçë është duke kryer përditësimin e pjesshëm të listës së inventarit të pronave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 3. Nëse po, si i keni menaxhuar ju atë? Sa janë të ardhurat e shtuara në buxhetin e bashkisë tuaj nga ky zë?Kryesisht si i keni përdorur?<br><br>Të ardhurat nga kontratat e qirasë për vitin 2024 janë 15,868,416 lek dhe janë përdorur për shpenzimet korrente të Bashkisë Korçë si dhe institucioneve në varësi.<br><br>4. Sa ambiente me qira keni marrë ju për institucionet vartëse? Sa është hapësira dhe sa është vlera që ju paguani për secalin rast?A mund të na vini në dispozicion kontratat konkrete për secalin rast?<br><br>· Bashkia Korçë nuk ka marrë me qira ambiente për institucionet vartëse.<br><br>5. A keni aplikuar taksën 3%për ndërtimet e reja?Si është vjelë kjo taksë,në vlerë monetare apo ambiente? Sa janë përfituar konkretisht para dhe sa sipërfaqe ndërtimi?Këto të ardhura për çfarë janë përdorur?<br><br>Në zbatim të detyrimeve ligjore disponuar në nenin 19 të Ligjit 22/2018 “Për Stehimin Social” i ndryshuar dhe VKM 325 dt. 29.05.2024 “Për përcaktimin e regullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”, nga Bashkia Korçë janë nënshkruar 9 akt marrëveshje paraprake për kalimin në favor të fondit publik të banesave sociale të 3% të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | sipërfaqes funksionale ndërtimore të objekteve të banimit në ndërtim.<br><br>Nga këto është nënshkruar kontrata përfundimtare me një subjekt i cili ka shlyer detyrimin ligjor në vlerën 6,824,521 lekë, para marrjes të çertifikatës së përdorimit.<br><br>Ndërsa përsa i përket të ardhurave nga taksa 3% për ndërtimet e reja për periudhën janar-mars 2025 është 6,824,521 lek dhe nuk është përdorur. | | |
| 7. | 16.05.2025 | Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar, emisioni "Vetting" kërkon si informacion:<br><br>1: Në përgjigjen që Shërbimi Social Shtetëror na ka vënë në dispozicion thuhet që në shtëpinë e fëmijës "Lulet e Vogla" në Korçë në 5 vitet e fundit ka rënë numri i fëmijëve deri në tre fëmijë.<br><br>- Ku kanë shkuar këta fëmijë?<br><br>2. Sa është numri i personave që janë të punësuar në këtë institucion? | 28.05.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 16.05.2025, sipas të dhënave të marra nga Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla" ju bëjmë me dije se:<br>**1. Në përgjigjen që Shërbimi Social Shtetëror na ka vënë në dispozicion thuhet që në shtëpinë e fëmijës "Lulet e Vogla" në Korçë në 5 vitet e fundit ka rënë numri i fëmijëve deri në tre fëmijë.**<br>**- Ku kanë shkuar këta fëmijë?**<br>Lëvizja e fëmijëve për vitet 2020-2025, për institucionin Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla" Korçë është si më poshtë:<br>1. Transferuar në institucione të tjera përkujdesi: 12 fëmijë<br>2. Birësuar: 4 fëmijë<br>3. Kthim në familje biologjike: 3 fëmijë<br>4. Kalim në familje kujdestare: 2 fëmijë<br>Gjithsej, gjatë viteve 2020-2025 janë trajtuar në institucion 21 fëmijë. Në 5 vitet e fundit është vërejtur një rënie graduale e numrit të fëmijëve të strehuar, për shkak të orientimit drejt alternativave | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Sa ka qenë buxheti i akorduar nga Bashkia Korçë për shtëpinë e fëmijës për gjashtë vitet e fundit? (2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025)<br><br>4: Ku shkojnë këto të ardhura, si shpërndahen?<br><br>7: Shtëpia e Fëmijës 0 – 5 në Korçë është në proces transformimi në kuadër të planit të deinstitcionalizimit. Çfarë do të thotë konkretisht kjo?<br><br>5: Sa është buxheti i ndarë në muaj për një fëmijë dhe si shpenzohen ato konkretisht?<br><br>6: A keni pasur raste kur nuk keni pranuar një fëmijë për t'u bërë pjesë e "Shtëpisë së fëmijës"? Nëse po, cila ka qenë arsyeja? | | komunitare dhe mbështetjes së familjeve biologjike apo kujdestare.<br>**2. Sa është numri i personave që janë të punësuar në këtë institucion?**<br>Sipas Urdhërit Nr 88, Datë 25.10.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror" është miratuar struktura e Shtëpisë së Foshnjës Korçë, "Lulet e Vogla", që në organikën e saj ka **14** pozicione:<br>1 Drejtor, 1 Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social, 8 Kujdestare, 1 Përgjegjës të Sektorit të Administratës, 1 Kuzhinier dhe 2 Pastruese. Sipas këtij urdhëri aktualisht janë **11** persona të punësuar, përkatësisht: 1 Drejtor, 1 Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social, 5 Kujdestare, 1 Përgjegjës të Sektorit të Administratës, 1 Kuzhinier, 2 Punonjëse Pastrimi.<br>Sipas Vendimit Nr 3, Datë 17.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Korçë "Për miratimin e strukturës analitike së ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Korçë për vitin 2025" , është miratuar struktura e Shtëpisë së Foshnjës Korçë "Lulet e Vogla", që në organikën e saj ka **8** pozicione: 1 Specialist Psikologe, 1 Specialist Punonjës Social, 4 Kujdestare, 1 Roje objekti dhe 1 Specialist Finance. Sipas këtij vendimi aktualisht janë **2** persona të punësuar, 1 Kujdestare dhe 1 Specialist Finance.<br>Për shkak të mungesës të fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion, bazuar gjithashtu në shkresën me nr.prot 2879, datë 02.04.2025 nga Ministra e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | “Bashkëpunim për vijimësinë e procesit të deinstitucionalizimit” , me Urdhër Kryetari u vendos që:<br>3 Kujdestare dhe 1 Kuzhiniere të kryejnë detyrat pranë Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit, Korçë<br>1 Kujdestare të kryejë detyrat pranë Sektorit të Shërbimeve për fëmijet me aftësi ndryshe në Drejtorine e Kujdesit Social, Korçë<br>1 Sanitare të kryejë detyrat pranë Qendrës Ditore të Zhvillimit,Korçë<br>1 Përgjegjëse e Sektori Social dhe 1 Kujdestare të kryejnë detyrat pranë Sektorit të Shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjet me bazë komunitare, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Korçë.<br>**3. Sa ka qenë buxheti i akorduar nga Bashkia Korçë për shtëpinë e fëmijës për gjashtë vitet e fundit? (2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025)**<br>**4. Ku shkojnë këto të ardhura, si shpërndahen?**<br>Përgjigjet për pikat 3 dhe 4: | | |

## Bashkia

| Vitet | Buxheti | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shpenzimet per paga | Shpenzimet per sigurime shoqerore dhe shendetesore | Shpenzimet operative | Transferta | Investime | Total |
| 2020 | 1,932,160 | 321,928 | 361,000 | | | 2,615,088 |
| 2021 | 1,618,013 | 270,398 | 526,824 | | 239,760 | 2,654,995 |
| 2022 | 1,556,917 | 259,840 | 1,200 | 60,000 | | 1,877,957 |
| 2023 | 1,282,358 | 214,760 | | | | 1,497,118 |
| 2024 | 2,261,392 | 382,098 | | | | 2,643,490 |
| Pl 2025 | 2,706,000 | 451,920 | | | | 3,157,920 |

## ShSSh

| Vitet | Buxheti faktik | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shpenzimet per paga | Shpenzimet per sigurime shoqerore dhe shendetesore | Shpenzimet operative | | Investime | Total |
| 2020 | 9,991,999 | 1,669,126 | 4,097,986 | | | 15,759,111 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2021 | 9,931,319 | 1,657,849 | 4,266,033 | | | 5,855,201 |
| 2022 | 9,757,895 | 1,629,290 | 3,497,659 | 220,000 | | 15,104,844 |
| 2023 | 11,601,006 | 1,917,406 | 1,722,797 | | | 15,241,209 |
| 2024 | 11,885,163 | 1,987,128 | 1,533,265 | 135,000 | | 15,540,556 |
| 2025 | 12,095,000 | 2,020,000 | 800,000 | | | 14,915,000 |
| | | | | | | - |

| **Vitet** | **Vl. e ushqimeve** |
|---|---|
| 2020 | 2,755,788 |
| 2021 | 2,666,032 |
| 2022 | 1,531,804 |
| 2023 | 589,112 |
| 2024 | 535,422 |
| 2025 | |

**5. Sa është buxheti i ndarë në muaj për një fëmijë dhe si shpenzohen ato konkretisht?**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në zbatim të Udhëzimit Nr.689, datë 02.10.2018 " PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE":<br>Pika 1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, është:<br>-Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 0-3 vjeç, të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 360 lekë.<br>-Për fëmijët e grupmoshës 4-5 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 400 lekë.<br>Institucioni zbaton me përpikmëri këto udhëzime.<br>**6. A keni pasur raste kur nuk keni pranuar një fëmijë për t'u bërë pjesë e "Shtëpisë së fëmijës"? Nëse po, cila ka qenë arsyeja?**<br>Pranimi i fëmijëve për trajtim në institucion rezidencial nuk bëhet nga institucioni, por nga SHSSH ose Këshilli Bashkiak apo Këshilli i Qarkut. (sipas vlerësimit multidisiplinar)<br>**7. Shtëpia e Fëmijës 0 – 5 në Korçë është në proces transformimi në kuadër të planit të deinstitcionalizimit. Çfarë do të thotë konkretisht kjo?**<br>Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç është përfshirë në planin kombëtar të deinstitucionalizimit, që synon zëvendësimin e institucioneve me shërbime komunitare si: kujdesi në familje pritëse, famile biologjike me mbështetje apo qendra ditore komunitare. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 8. | 02.06.2025 | Ju drejtohemi per te kerkuar informacion mbi:<br><br>1. Numrin e aplikimeve te nxenesve te arsimit parauniversitar, per vitin shkollor 2024-2025 per te perfituar burse sipas VKM-së nr 666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” i ndryshuar<br><br>2. Numrin e nxenesve qe kane perfituar burse per vitin shkollor 2024-2025 sipas VKM se siper permendur | 11.06.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 02.06.2025, sipas të dhënave të marra nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë ju bëjmë me dije se:<br>1. Numri i aplikantëve të nxënësve për bursa për vitin shkollor 2024-2025 sipas VKM 666 datë 10.10.2017 të ndryshuar ka qenë **617 aplikime nga Arsimi Parauniversitar** ( 519 nxënës nga shkollat 9-vjeçare dhe 98 nxënës nga gjimnazet) dhe **503 aplikime për shkollat Profesionale** ( 205 nxënës në shkollat Profesionale Teknike dhe 298 nxënës nga shkollat Profesionale Shërbime).<br><br>2. Numri i nxënësve që kanë përfituar bursë për vitin shkollor 2024-2025 është **350 nxënës nga Arsimi Parauniversitar** (256 nxënës nga shkollat 9-vjeçare dhe 94 nxënës nga gjimnazet) **dhe 503 nxënës në shkollat Profesionale.**<br><br>3. Numri i nxënësve që i përkasin kategorisë **"Familje në nevojë"** është **58 nga Arsimi Parauniversitar** (54 nga shkollat 9-vjeçare dhe 4 nga gjimnazet), ndërsa për **Arsimin Profesional është 66** | E plotë | S’ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Sa prej perfitueseve i perkasin kategorise " Familje ne nevoje"<br><br>4. Sa kane qene kuotata e percaktuara nga MAS dhe MEKI-t per perfitimin e bursave per vitin shkollor 2024-2025 | | **nxënës** (26 nxënës Shkollat Profesionale Shërbime dhe 40 nxënës Shkollat Profesionale Teknike)<br><br>4. Kuotat e përcaktuara nga **MAS kanë qenë 350 bursa** për vitin 2024-2025, ndërsa **MEKI jep bursa për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret sipas VKM-së 666 e ndryshuar datë 10.10.2017.** | | |
| 9. | 20.06.2025 | Kërkesë për informacion mbi:<br><br>1. Emrin e subjektit/kompanise qe ka kontrate me bashkine per grumbullimin, transportin, dhe/ose trajtimin e mbetjeve per vitin 2023-2024.<br><br>2. Destinacioni final i mbetjeve pas grumbullimit, si dhe cdo informacion tjeter te rendesishem qe lidhet me skemen e menaxhimit te mbetjeve ne territorin qe menaxhon bashkia. | 23.06.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 20.06.2025 po ju vendosim në dispozicion të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, Bashkia Korçë:<br>1. Emri i firmës që ka kontratë me bashkinë për grumbullimin, transportin e mbetjeve për vitin 2023-2024 është firma "Korsel".<br>2. Destinacioni final i mbetjeve është Landfilli në Maliq. | E plotë | S'ka tarifë |
| 10. | 30.06.2025 | Në bazë të ligjit nr 119/2014 për të drejtën për informim, kërkoj informacion përsa i përket: | 03.07.2025 | Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 30.06.2025, po ju vendosim në dispozicion të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, Bashkia Korçë:<br>Vlera e investimit për Bibliotekën "Thoma Turtulli" është 25,276,204.18 lekë. | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - Më vendosni në dispozicion projektin e rikonstruksionit të bibliotekës së fëmijëve<br><br>- Sa është buxheti për rikonstruksionin e kësaj ndërtese dhe cila kompani po kryen punimet?<br><br>- Përse nuk është vendosur një tabelë informuese për punimet ashtu siç e kërkon ligji? | | Tabela është vendosur në objekt, bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe një foto. | | |
| 11. | 03.07.2025 | Në kuadër të monitorimit të investimeve strategjike dhe administrimit të pronave publike në territorin tuaj, ju kërkojmë të na vënë në dispozicion dokumentacionin zyrtar për periudhën nga viti 2016 deri më sot, në lidhje me:<br><br>1. Vendimet e Këshillit Bashkiak që kanë miratuar kalimin e pronave publike në favor të investitorëve strategjikë në territorin e bashkisë tuaj, duke përfshirë numrin, datën dhe përshkrimin e pronave të përfshira.<br><br>2. Buxhetet, fondet apo ndihmat e tjera financiare që bashkia ka miratuar ose dhënë për | 11.07.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 03.07.2025, ju bëjmë me dije se:<br>1. Nuk ka asnjë Vendim Këshilli Bashkiak për kalim të pronave publike në favor të investitorëve strategjikë në territorin e Bashkisë Korçë.<br>2. Nuk kemi miratuar ose dhënë buxhete, fonde apo ndihma të tjera financiare për investitorët strategjikë.<br>3. Nuk kemi investime në infrastrukturë me përfitues investitorët strategjikë.<br>4. Nuk kemi projekte infrastrukturore të parashikuara me përfitues investitorët strategjikë.<br>5. Nuk kemi asnjë akt, marrëveshje apo dokument tjetër që lidhet me marrëdhëniet institucionale dhe financiare mes bashkisë dhe investitorëve strategjikë. | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | investitorët strategjikë në territorin tuaj.<br><br>3. Investimet e bashkisë tuaj në infrastructure me përfitues investitorët strategjikë.<br><br>4. Projektet infrastrukturore të parashikuara dhe buxhetet përkatëse me përfitues investitorët strategjikë.<br><br>5. Çdo akt, marrëveshje apo dokument tjetër që lidhet me marrëdhëniet institucionale dhe financiare mes bashkisë dhe investitorëve strategjikë. | | | | |
| 12. | 09.07.2025 | 1- Pista e Skive në Korçë:<br><br>• A është siguruar deri tani ndonjë burim konkret financimi për projektin e resortit dimëror dhe pistës së skive?<br><br>• A janë përfshirë investitorë privatë apo është aplikuar për fonde qeveritare/kombëtare/ndërkomb ëtare?<br><br>• Nëse po, mund të na vini në dispozicion emrat e partnerëve | 17.09.2025 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 09.07.2025, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës ju bëjmë me dije se:<br>1. Pista e Skive në Korçë<br>Në lidhje me pistën e skive nuk kemi informacion.<br>2. Gazifikimi në Korçë<br>Ka përfunduar studimi i parafizibilitetit nga kompania "Socar". Për të ecur më tej me projektin pritet nënshkrimi i marrëveshjes midis qeverisë shqiptare dhe asaj azerbajxhanase. Pas nënshkrimit do të na bëhen me dije hapat dhe afatet.<br>3. Aeroporti në Lumalas<br>• A ka përfunduar zbatimi i projektit për aeroportin sportiv në Lumalas? | E plotë | S’ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | apo dokumentet përkatëse të bashkëpunimit?<br><br>• A është hartuar ndonjë plan fizibiliteti për projektin? Nëse po, mund të vihet në dispozicion?<br><br>• Po projekt teknik i detajuar?<br><br>• A është përfshirë ndonjë konsulent apo kompani për projektimin dhe zbatimin e tij?<br><br>• Pse është përzgjedhur zona e malit të Gramozit dhe cilat janë rezultatet e monitorimit klimatik të deritanishëm?<br><br>• A ka bashkia ndonjë marrëveshje formale me qeverinë shqiptare për bashkëfinancim apo mbështetje teknike?<br><br>• A është përfshirë Federata Shqiptare e Skive në këtë projekt? Nëse po, në çfarë roli konkret?<br><br>2- Gazifikimi në Korçë | | Zbatimi i projekit ka përfunduar plotësisht, jemi në fazë çertifikimi.<br><br>• Nëse jo, cila është faza aktuale e punimeve dhe kur parashikohet përfundimi i tyre?<br><br>• Sa është kostoja përfundimtare e projektit?<br><br>Financimi i këtij projekti është nga Fondit Shqiptar i Zhvillimit.<br><br>• A ka një plan konkret për funksionimin e aeroportit pas përfundimit të ndërtimit?<br><br>Planin konkret për këtë projekt do t'ja u vemë në dispozicion pasi të përfundojë Çertifikimi.<br><br>• Kush do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe operimin e tij?<br><br>Përgjegjës për mirëmbajtjen dhe operimin e tij do të jetë Bashkia Korçë me mbështetjen e Autoritetit të Aviacionit Civil, të cilët bëjnë dhe çertifikimin e fushës.<br><br>• A janë planifikuar evente të para sportive ose fluturime prove pas përfundimit të projektit?<br><br>Pasi të përfundojë proçesi i çertifikimit të fushës do të bëhet planifikimi i fluturimeve sportive. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | • Cili është statusi aktual i projektit të gazifikimit të Korçës? A ka filluar ndonjë fazë konkrete e zbatimit?<br><br>• A janë hartuar planet e detajuara të zbatimit për projektin dhe cilat janë afatet kohore zyrtare për secilën fazë?<br><br>• Cilat janë burimet e financimit për projektin?<br><br>• Nëse ka kontrata apo marrëveshje me kompani që do të kryejnë punimet, a mund të vihet në dispozicion emri i tyre dhe dokumentacioni përkatës?<br><br>• A është përgatitur një studim fizibiliteti apo projekt teknik për gazifikimin? Nëse po, kur është përfunduar dhe nga kush është hartuar?<br><br>• A është bërë një analizë kosto-përfitim për projektin?<br><br>• Cilat janë zonat specifike të qytetit të Korçës që përfshihen në fazën e parë të projektit të gazifikimit? | | • A është lidhur ndonjë marrëveshje me Shoqatën Shqiptare të Aeronautikës apo ndonjë operator tjetër ajror?<br><br>Nuk ka marrëveshje konkrete, sepse duhet të perfundoje Çertifikimi.<br><br>4. Rruga Lumalas-Melçan<br><br>• Cili është progresi aktual i punimeve në segmentin rrugor Lumalas – Teqeja e Melçanit?<br><br>Punimet në këtë segment kanë përfunduar në muajin qershor.<br><br>• Kur pritet të përfundojë zyrtarisht ky segment?<br><br>Punimet në këtë segment kanë përfunduar në muajin qershor.<br><br>• Cili është vlera totale e projektit dhe sa financohet nga FSHZH?<br><br>Vlera totale e projektit financohet e gjitha nga FSHZH.<br><br>• Cili është subjekti (kompania) që po realizon punimet?<br><br>Kompania që po kryen punimet është "Shkëlqimi 07". | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | • Sa familje, biznese apo institucione parashikohet të përfitojnë nga ky projekt në dy vitet e para?<br><br>• Çfarë masash janë planifikuar për të garantuar që projekti do të jetë "miqësor me mjedisin", siç është premtuar?<br><br>• A është zhvilluar një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe cili është rezultati i tij?<br><br>3- Aeroporti në Lumalas<br><br>• A ka përfunduar zbatimi i projektit për aeroportin sportiv në Lumalas?<br><br>• Nëse jo, cila është faza aktuale e punimeve dhe kur parashikohet përfundimi i tyre?<br><br>• Sa është kostoja përfundimtare e projektit?<br><br>• A ka një plan konkret për funksionimin e aeroportit pas përfundimit të ndërtimit? | | • Si lidhet kjo rrugë me projektin e Aeroportit Sportiv në Lumalas? A parashikohet të shërbejë si akses kryesor për të?<br><br>Kjo rrugë lidh fshatin Lumalas me Teqenë e Melçanit.<br><br>Në këtë rrugë lidhet dhe rruga që shkon për tek Aeroporti Sportiv, e cila parashikohet të shtrohet në një projekt të financuar nga FSHZH. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | • Kush do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe operimin e tij?<br><br>• A janë planifikuar evente të para sportive ose fluturime prove pas përfundimit të projektit?<br><br>• A është lidhur ndonjë marrëveshje me Shoqatën Shqiptare të Aeronautikës apo ndonjë operator tjetër ajror?<br><br>4- Rruga Lumalas-Melçan<br><br>• Cili është progresi aktual i punimeve në segmentin rrugor Lumalas – Teqeja e Melçanit?<br><br>• Kur pritet të përfundojë zyrtarisht ky segment?<br><br>• Cili është vlera totale e projektit dhe sa financohet nga FSHZH?<br><br>• Cili është subjekti (kompania) që po realizon punimet?<br><br>• Si lidhet kjo rrugë me projektin e Aeroportit Sportiv | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në Lumalas? A parashikohet të shërbejë si akses kryesor për të? | | | | |
| 13. | 20.07.2025 | Referuar hidrocentraleve që po ndërtohen apo që operojnë në territorin e bashkisë tuaj, kërkoj, si vijon:<br><br>Gjendja e HEC-eve:<br><br>1. Listen e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët e lumenjve mbi të cilat po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë?<br><br>2. Njësitë administrative (apo fshatrat) në rë cilat janë vendosur këto HEC-e.<br><br>3. Njësitë administrative (apo fshatrat ) në rë cilat janë vendosur panelet fotovoltaike (nëse ka).<br><br>4. Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë | 01.08.2025 | Referuar hidrocentraleve që po ndërtohen apo që operojnë në territorin e bashkisë tuaj, kërkoj, si vijon:<br><br>Gjendja e HEC-eve:<br><br>1.Listen e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët e lumenjve mbi të cilat po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë?<br>HEC-et qe operojne ne bashkine Korce jane HEC Dishnica Energji, HEC Kamenice, HEC Energji Xhaci, HEC Gjanc, HEC Elektro Lubonja, HEC Vithkuq, HEC Treska, HEC Hydro Power Panarit, HEC Cemerica, HEC Denas Power, HEC Voskopoje, HEC Nishani, HEC Balkan Green Energy.<br><br>2.Njësitë administrative (apo fshatrat) në rë cilat janë vendosur këto HEC-e.<br>NjA Vithkuq, NjA Voskopoje, NjA Bulgarec, NjA Lekas, NjA Mollaj.<br><br>3.Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur panelet fotovoltaike (nëse ka).<br>Nuk ka. | E plotë | S’ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
